



INFORMACIONI I PROJEKTIT

Menaxhimi ndërkufitar i zonave të mbrojtura në Ballkanin Perëndimor



Vargmal në zonën ndërkufitare
Alpet Shqipërisë - Prokletije

Source: Igor Stojović

Konteksti

Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, projekti kontribuon në forcimin e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai fokusohet veçanërisht në zbatimin e Konventës së Bernës dhe rrjetit Natura 2000, duke punuar gjithashtu drejt arritjes së objektivave të përcaktuara në Deklaratën e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Vëmendja kryesore është në dy rajone pilot ndërkufitare: Shebenik-Jabllanicë (Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut) dhe Alpet e Shqipërisë-Prokletije (Shqipëria dhe Mali i Zi). Të dy rajonet kanë biodiversitet të pasur dhe janë pjesë e Brezit të Gjelbër të Ballkanit.

Project details

Projekti synon të forcojë kapacitetet e autoriteteve vendore dhe kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor në menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe të përmbushë kërkesat e Konventës së Bernës dhe të krijojë zona të njohura të mbrojtura brenda rrjeteve Emerald dhe Natura 2000. Në dy rajonet pilot, palët e interesuara do të mësojnë si të monitorojnë speciet dhe habitatet kryesore në përputhje me standardet e Natura 2000. Rekomandimet e politikave do të rrisin efektivitetin e menaxhimit të zonave të mbrojtura, me fokus në Natura 2000, duke zgjeruar përvojat në nivel kombëtar dhe duke përshkruar qasje për harmonizimin e menaxhimit ndërkufitar. Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin për vlerën e biodiversitetit midis vendimmarrësve, bizneseve dhe shoqërisë civile, si dhe të nxisë shkëmbimin dhe të forcojë bashkëpunimin midis grupeve kombëtare të interesit për ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin ndërkufitar të zonave të mbrojtura në rajonet pilot. Gjatë Konferencës Rajonale të Brezit të Gjelbër të Ballkanit, palët relevante do të ndajnë përvojat e tyre për të shfrytëzuar rezultatet e projektit.

Përditësuar: Mars 2026

Rajoni: Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut

Kohëzgjatja: 11/2025 – 10/2027

Grupi i synuar për këshillim: Përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe autoriteteve të tyre në varësi, si dhe përfaqësues vendorë në vendet e synuara, Administrata të Zonave të Mbrojtura dhe Grupet Lokale të Veprimit

Organizatat implementuese: EuroNatur Stiftung Europäisches Naturerbe

Numri i projektit: 3725510102

Menaxhimi Tematik:

Ministria Federale për Mjedisin, Veprimet Klimatike, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMUKN)
Jakob Kießling
Tel.: +49 (0) 151 728 67 146
Jakob.Kießling@bmukn.bund.de

Koordinimi i projektit:

Njësia e shërbimit të Projektit AAP
Dr. Barbara Beckert
Tel.: +49-340-2103-2359
barbara.beckert@uba.de

Advisory Assistance Programme (AAP)

Programi i Ndhmës së Këshillimit për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukaz, Azi Qendrore dhe vende të tjera fqinje të Bashkimit Evropian; një program i Ministrisë Federale për Mjedisin, Veprimet Klimatike, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore

AAP Njësia e Shërbimit të Projektit:

AAP-info@uba.de

www.uba.de/en/project-database-advisory-assistance-programme
www.uba.de/en/advisory-assistance-programme